



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

PLANI I VEPRIMIT

PËR MENAXHIMIN E RISQEVË TË INTEGRITETIT

PËR MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

2022-2025

OBJEKTIVI 1: PËRMIRËSIMI I ETIKËS DHE MEKANIZMAVE TË INTEGRITETIT NË MINISTRI

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
1	Mungesa përditësimi i kuadrit të brendshëm rregullator të ministrisë në lidhje me aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit.	Reputacional/Burime Njerëzore	Mesatar	Përditësimi i kuadrit të brendshëm rregullator të Ministrisë me rregulla: a) rregulla për pranimin e donacioneve/sponsorizimeve dhe funksionimit të regjistrit përkatës; b) rregulla për deklarimin nga ana e punonjësve të institucionit të takimeve me lobistë si edhe funksionimin e një regjistri përkatës. 2. Subjekte të këtyre rregullave të parashikohen punonjësit ministrisë, funksionarët e lartë - Ministër dhe Zv/Ministër, Kabineti dhe Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues në Ministri.	Grup pune me punonjës të ministrisë për hartimin e këtyre rregullave si përditësim Kodit të Etikës së Ministrisë dhe rregullores së Brendshme Gjashtë mujori i dytë 2023
2	Njohuri të pamjaftueshme për etiken, konfliktin e interesave, mos diskriminimin, të punonjësve të përfshirë në hartimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratave publike (nga pyetësi anonim).	Burimet Njerëzore/ Reputacional dhe Imazhi	Mesatar	Ofrimi i trajnimeve për etiken, konfliktin e interesave, mos diskriminimin, të punonjësve të përfshirë në procesin e hartimit dhe monitorimit të zbatimit të kontratave publike.	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ASPA) Gjashtë mujori i parë 2023 dhe në vazhdim

3	Ndërgjegjësim i ulët mbi mekanizmat e brendshëm për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.	Burimet Njerëzore/ Operacional	Mesatar	Të realizohet një plan trajnimi/takimesh informuese dhe ndërgjegjësuere për punonjësit e MIE-së mbi mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve, rolit të njësisë përgjegjëse, si dhe mbi parashikimet e ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes ndaj hakmarrjes.	Njësia Përgjegjëse për mbrojtjen e sinjalizuesve + BNJ (Gjashtëmujori i parë 2023)
4	Mungesë informacioni për publikun mbi mekanizmat kontrollues dhe monitorues në MIE.	Operacional	Mesatar	Zbatim i detyrimit ligjor, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale, për të bërë transparentë mekanizmat kontrollues dhe monitorues në MIE, nëpërmjet publikimit të raporteve të Auditit dhe KLSH tek seksioni përkatës i Programit të Transparencës.	Koordinatori për të drejtën për informim (Gjashtëmujori i parë 2023 e në vijim)
5	Njohuri të pamjaftueshme për etiken, konfliktin e interesave, mosdiskriminim, te punonjësve te përfshirë ne hartimin dhe monitorimin e zbatimit te kontratave publike (nga pyetesori anonim).	Burimet Njerëzore/ Reputacional dhe Imazhi	Mesatar	Ofrimi i trajnimeve për etiken, konfliktin e interesave, mosdiskriminim, te punonjesve te përfshirë ne procesin e hartimit dhe monitorimit të zbatimit te kontratave publike.	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ASPA) Gjashtë mujori i parë 2023 dhe në vazhdim

OBJEKTIVI 2: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSË

Fusha e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
6	<p>Procedura jo shume të hollësishme mbi proceset e punës, për zbërthimin e kuadrit rregullator në kontekstin e MIE:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 18.7% e punonjësve të anketuar përgjigjet se procedurat e punës që ndjekin nuk janë të përshkruara dhe dokumentuara me hollësi. - 6.6% nuk ka dijeni mbi procedura apo dokumentim të tillë. - Rreth 15% e të anketuarve deklarojnë se edhe në rastin kur ka procedura, ato nuk garantojnë një ndarje të përshtatshme të detyrave. 	Operacional	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i PSV të detajuara dhe të qarta për zbërthimin e kuadrit rregullator të proceseseve të ndryshme të punës në kontekstin e MIE.	<p>Grup Pune</p> <p>(Gjashtëmuji i dytë 2024)</p>

7	<p>1. Mosrakordimi me ASPA për trajnimin e stafit në fushat e përgjithshme.</p> <p>2. Mungesë e një analize mbi nevojat dhe e një plani trajnimesh për rritjen profesionale të stafit për detyra specifike/teknike të MIE.</p>	Operacional	Mesatar	<p>1. Vlerësimi i nevojave për trainim dhe hartimi i një plani trainimi për stafin e Ministrisë në bashkëpunim me ASPA, Institucionet e Specializuara apo jashtë vendit për detyra specifike me financim nga buxheti i Ministrisë.</p> <p>2. Hartim dhe zbatim i procedurave për transferimin e njohurive dhe shpërndarjen e materiale trainuese nga personat e trainuar punonjësve të tjerë që kanë interes në mënyrë që të sigurohet një përfitim maksimal.</p>	<p>BNJ në bashkëpunim me strukturat e MIE</p> <p>(Gjashtëmujori i parë 2023 e në vijin)</p>
---	--	-------------	---------	---	---

Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronike					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
8	<p>1. Pamundësi e identifikimit dhe përpunimit në kohë të dokumentacionit të trashëguar nga fondet e mëdha paraardhëse.</p> <p>2. Mungesa e kushteve optimale të ruajtjes së informacionit që mund të sjellë humbje/dëmtim të tij.</p>	Operacional	Mesatar	<p>1. Rivlerësim i mundësisë për risistemim të dokumenteve arkivore të mbartura.</p> <p>2. Vlerësimi i mundësisë për përmirësimin e kushteve teknike të ambienteve të arkivës.</p>	<p>Grup Pune</p> <p>(Gjashtëmujori i Dytë 2024)</p>
9	Cenimi i realizimit të detyrave të protokollit dhe arkivit në kohë dhe cilësi për shkak të stafit të pamjaftueshëm dhe vendeve vakante që shkaktojnë mbingarkesë në stafin ekzistues.	Burimet Njerëzore/ Operacional	Mesatar	<p>Marrja e masave për plotësimin e vakancave në kohë të shkurtër.</p> <p>Vlerësimi në kuadër të ristrukturimit apo i praktikave të marrjes së stafit shtesë.</p>	<p>BNJ</p> <p>(Gjashtëmujori i parë 2023)</p>

10	<p>1. Mungesa e realizimit të procedurës së back-up-it nga IT/sistem i përgjithshëm, duke e bërë të vështirë pajisjen me dokumentacionin elektronik dhe vijimin e detyrës së punonjësve të emëruar rishtazi.</p> <p>2. Dokumentacion që nuk gjendet në formë shkresore në arkivë mund të sjellë vështirësi dhe pamundësi në kryerjen e detyrave funksionale.</p>	Teknologjia e Informacionit/ Operacional	I lartë	<p>1. Zbatimi i procedurës për realizimin e back-up, në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe vënia në dispozicion e dokumentacionit elektronik, punonjësve të emëruar rishtazi.</p> <p>2. Koordinim me AKSHI-në,</p>	<p>BNJ + AKSHI</p> <p>(Gjashtëmujori i dytë 2020 e vijim)</p>
11	Mospërshtatshmëria e sistemeve ekzistuese të IT-së për shkak të kapaciteteve të ulëta të ruajtjes së informacionit.	Teknologjia e Informacionit/ Operacional	I lartë	Marrja e masave për ngritjen e kapaciteteve storage të sistemeve IT, në përputhje me analizën e volumit të punës në MIE.	<p>GMS + IT</p> <p>(Gjashtëmujori i dytë 2024)</p>
12	Moszbatimi i linjave hierarkike në sistemin elektronik, për përcjelljen dhe miratimin e dokumentacionit të hartuar cenon procesin e raportimit dhe identifikimin e përgjegjësive për punën e kryer.	Teknologjia e Informacionit/ Operacional	Mesatar	Ndjekja e linjave hierarkike të raportimit dhe kontrollit mbi shkresat e hartuara në sistemin elektronik për evidentimin e qartë të detyrës së kryer dhe mbajtjen e përgjegjësive.	<p>Nëpunësi Autorizues + IT</p> <p>(Gjashtëmujori i dytë 2022 e vijim)</p>
13	Mangësi në pajisjet e nevojshme, si skanera, për ngarkimin e dokumentacionit në sistemin elektronik.	Teknologjia e Informacionit/ Operacional	Mesatar	Marrja e masave, mbi bazën e analizës së volumit të punës, për sigurimin e pajisjeve të nevojshme si skanera, për ngarkimin me eficiencë të dokumentacionit në sistemin elektronik.	<p>GMS + IT</p> <p>(Gjashtëmujori i parë 2023)</p>

2.3. Fusha e Partneritetit Publik Privat në Fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
14	1. Mungesa e nje PSV të brendshme per koncensionet.	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	I larte	Hartimi i nje PSV per koncensionet (nga identifikimi I nevojave , realizimi, zbatimi).	Gup Pune / Titullari Gjashtë mujori i dyte 2024
15	Mungesë burimesh njerëzore te kualifikuara për përmbushjen e funksionit të Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në Fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë.	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual	I lartë	Plotesimi i struktures si dhe analiza e nevojës për trainimin e tyre me risitë ligjore apo të sistemeve informatike.	DPPP + BNJ/DAP (Gjashtëmujori i parë 2023)
16	Mungese e nje kalendari trajnimi për përditësimin e njohurive mbi legjislacionin në fushën e prokurimeve dhe koncensioneve për punonjësit e kësaj drejtorie.	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	Ofrimi i trajnime për përditësimin e legjislacionit në fushën e prokurimeve dhe koncensioneve për punonjësit e kësaj drejtorie.	Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ASPA) Gjashtë mujori i parë 2023 dhe në vazhdim

17	Mos publikimi i listës së kontratave koncensionare të nënshkuara nga MIE.	Operacional	Mesatar	Publikimi i listes se kontratave koncensionare koncensionare të nënshkuara nga MIE.	Drejtoria e Partneritetit Publik Privat ne Fushen e Infrastrukturës dhe Energjisë + Koordinatori për të Drejtën për Informim Gjashtë mujori i parë 2023 dhe në vazhdim
18	Mungesa e një PSV të brendshme në lidhje me trajtimin e ankesave për procedurat konkurruese për procesin e prokurimeve apo PPP.	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	<p>1. Ne kuader te Hartimit dhe miratimit të PSV të brendshme ne MIE të përfshihet dhe trajtimi i ankesave për procedurat konkurruese për procesin e prokurimeve apo PPP.</p> <p>2 Ofrimi I trajnimeve për K.Pr. Administrative për punonjësit e kësaj drejtorie për trajtimin e kërkesave dhe ankesave.</p>	2. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ASPA) Gjashtë mujori i parë 2023 dhe në vazhdim

OBJEKTIVI III: RRRITJA E TRANSPARENCËS DHE Pjesëmarrjes Qytetare

Fusha e transparencës dhe llogaridhënies					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
19	<p>1. Mungesa e aktit për ngarkimin e detyrave shtesë, si ajo e koordinorit për të drejtën e informimit, që mund të sjellë riskun e pamundësisë ligjore për kërkim llogarie ndaj/mbajtje përgjegjësie prej punonjësit përkatës.</p> <p>2. Mungesa e përcaktimit të detyrave të koordinorit për të drejtën e informimit në Rregulloren e Brendshme apo akte të tjera.</p> <p>3. Mungesa e detajimit të linjave të bashkëpunimit, raportimit, afateve dhe përgjegjësive brenda MIE-së, për kthim përgjigje kërkesave për informim.</p>	Operacional/ Reputacioni dhe Imazhi	I lartë	<p>1. Të miratohet me Urdhër Titullari koordinori për të drejtën e informimit si një detyrë shtesë, përkrah atyre funksionaleve.</p> <p>2. Caktimi i koordinorit të bëhet duke vlerësuar ngarkesën mes detyrës shtesë dhe detyrës funksionale/ose detyra shtesë të realizohet me rrotacion për të mos mbingarkuar gjatë një person.</p> <p>3. Të përfshihen detyrat e koordinorit për të drejtën e informimit në Rregulloren e Brendshme ose aktin e posaçëm.</p> <p>4. Parashikimi në PSV/Manual procedurash i linjave të komunikimit të koordinorit me strukturat e MIE-së, afatet dhe mekanizmat për identifikimin e përgjegjësive për moszbatimin e detyrimeve ligjore mbi dhënien e informacionit me kërkesë.</p>	<p>Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator</p> <p>(Gjashtëmuajori i parë 2023 për aktin/detyrat në Rregullore në afatin e rishikimit të saj)</p>

20	<p>1. Mangësi mbi transparencën e mekanizmave kontrollues dhe monitorues mbi MIE-në, të cilat garantojnë monitorimin nga publiku.</p> <p>2. Paaksesueshmëri e informacionit në PT, si pasojë e çështjeve teknike në web.</p>	Operacional/ Reputacioni dhe Imazhi	I lartë	<p>1. Të plotësohet programi i transparencës me dokumentacionin që duhet dhënë pa kërkesë, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>2. Të zgjidhen problemet teknike të websitit të MIE-së, në mënyrë që informacioni i hedhur tek programi i transparencës të bëhet i aksesueshëm.</p> <p>3. Hartimi i një liste kontrolli mbi plotësinë e publikimeve në faqen e web-it.</p>	<p>Koordinatori+Drejtoritë e Përbajtjes + IT</p> <p>(Gjashtëmuji i parë 2023 e në vijim)</p>
21	<p>1. Draft-aktet e shumta për konsultim publik mbingarkojnë koordinatoren për njoftim dhe konsultim publik, duke cënuar cilësinë e detyrës specifike dhe atyre funksionale.</p> <p>2. Mungon përcaktimi i detyrave të koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik në Rregulloren e Brendshme apo akt të veçantë.</p> <p>3. Mungon përcaktimi në Manual procedurash/PSV, i linjave të bashkëpunimit dhe raportimit mes strukturave të MIE-së dhe koordinorit, si dhe mbi afatet dhe mekanizmat e identifikimit të përgjegjësive për moszbatim të dispozitave të ligjit.</p>	Operacional	I lartë	<p>1. Të vlerësohet nga MIE-ja mundësia e ngritjes me akt të Titullarit të një rrjeti koordinorësh të përbërë nga punonjës të ministrisë, nën drejtimin e Koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.</p> <p>2. Të përfshihen detyrat e koordinorit/rrjetit të konsultimit publik në Rregulloren e Brendshme të Institucionit apo aktin e veçantë.</p> <p>3. Të hartohen procedura/mekanizma për bashkëpunimin mes strukturave të MIE-së me koordinatoren për konsultimin publik, ku të parashikohen afatet dhe mekanizma për identifikimin e përgjegjësive për moszbatim të ligjit.</p>	<p>Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator</p> <p>(Gjashtëmuji i parë 2023 për aktin/detyrat në Rregullore në afatin e rishikimit të saj)</p>

OBJEKTIVI IV: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR, MONITORIMIT DHE KONTROLLIT TË BRENDSHËM

1. Fusha e Menaxhimit Financiar					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
22	<p>1. Mungesa e PSV për zbërthimin e rregullave dhe procedurave të kuadrit rregullator në procesin e hartimit dhe zbatimit të kërkesave buxhetore</p> <p>2. Mosparashikimi i sakte dhe në kohë i nevojave dhe kërkesave në nivel programesh për hartimin e PBA-së.</p> <p>3. Mungesa e një kalendari trajnimi te vazhdueshëm për përditësimin e te rejave te kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin.</p>	Operacional	Mesatar	<p>1. Miratimi i PSV/ Udhëzimit të brendshëm për procesin e hartimit të kërkesave buxhetore në kontekstin e Ministrisë, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Standard të MF.</p> <p>2. Miratimi dhe zbatimi i kalendarit të brendshëm për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe monitorim i zbatimit të tij;</p> <p>3. Miratimi i programit shtese ne nivel anëtarësh te ekipeve te programeve buxhetore mbi procedurat dhe afatet standarde per përgatitjen e programeve buxhetore.</p>	Grup Pune / GMS (Gjashtëmujori i parë 2023 e çdo vit buxhetor)

23	<p>1. Mungesa e PSV-ve dhe rregullave specifike për zbërthimin e kuadrit rregullator në kontekstin e MIE-së për procesin e monitorimit të buxhetit</p> <p>2. Mos respektim i afateve të raportimeve të treguesve buxhetor.</p>	Operacional/ Financiar	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i procedurave dhe kalendarit që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit, si zbërthim i kuadrit rregullator në kontekstin kompleks të MIE-së. (Manuale të detajuara mbi procesin).	Grup Pune / GMS (Gjashtëmuajori i parë 2023 e çdo vit buxhetor)
24	Mungesë transparence në lidhje me publikimin e raporteve 4 mujore të monitorimit në faqen e web-it të MIE.	Operacional/ Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	<p>1. Publikimi i raporteve të monitorimit të seksioni përkatës i PT sipas Udhëzimit Standard dhe ligjit për të drejtën e informimit.</p> <p>2. Përgatitja një listë kontrolli për plotësinë e publikimeve.</p>	Koordinatori për Info + Nëpunësi Autorizues (Gjashtëmuajori i dytë 2022 dhe në vijim sipas afateve ligjore)
25	Mungesa e akteve për përcaktimin e qartë të fushave të kompetencës dhe detyrimeve buxhetore ndaj shoqërive aksionere/konservim/likuidim ne pronësi të MFE.	Operacional/ Financiar	Mesatar	1. Bashkërendimi me MFE për hartimin e akteve për përcaktimin e qartë të fushave të kompetencës dhe detyrimeve përkatës për shoqërive aksionere/konservim/likuidim.	Titullari/Nëpunësi autorizues (Gjashtëmuajori i parë 2024)
26	<p>1. Mungesa apo parregullësi në dokumentet justifikuese dhe vërtetuese, bashkëlidhur praktikave të likuidimit.</p> <p>2. Mosrespektimi i afateve për dorëzimin e praktikave, për likuidimin e faturave dhe kryerjen e pagesave në kohë.</p>	Operacional/ Financiar	Mesatar	Në kuadër të miratimit të PSV të përfshihen dhe procedurat me afatet, si dhe dokumentacioni tip i nevojshëm justifikues/vërtetues për praktikën e likuiduesve.	Grup Pune D Financave +Prokurimet+BNJ (Gjashtëmuajori i parë 2023)

27	<p>1. Mungesa e PSV të detajuara të MIE për rregullat e ruajtjes, mbrojtjes, dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve.</p> <p>2. Mungesa e vlerësimit të mundësisë të riciklimit të aktiveve dhe gjenerimit të të ardhurave prej tyre pas nxjerrjes jashtë përdorimit.</p>	Operacional/ Financiar	Mesatar	<p>1. Hartim i PSV në përputhje me detyrimet e kuadrit rregullator për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të MIE.</p> <p>2. Sugjerohet riciklimi si një opsion më i mirë mjedisor dhe që gjeneron të ardhura pas vlerësimit të aktivëve jashtë përdorimit, ku është e aplikueshme.</p>	<p>Grup Pune D Financave +Prokurimet+BNJ</p> <p>(Gjashtëmuji i dytë 2023)</p>
28	<p>Mungesë burimesh njerëzore të kualifikuara në strukturat e nëpunësit zbatues për përmbushjen e funksionit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.</p>	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual	I lartë	<p>Trajtimi financiar në pagë për sektorin e financës të jetë i kategorisë III/a për përgjegjësin e sektorit dhe III/b për specialistët.</p> <p>Plotësimi i strukturës si dhe analiza e nevojës për trajnimin e tyre me risitë ligjore apo të sistemeve informatike.</p>	<p>DBMF + BNJ/DAP</p> <p>(Gjashtëmuji i parë 2023)</p>
29	<p>1. Mos hartimi i projekteve dhe specifikimeve teknike me cilësinë dhe në kohën e duhur.</p> <p>2. Specifikime teknike që mund të çenojnë parimin e barazisë dhe të rrisin ankimet ndaj autoritetit kontraktor.</p> <p>3. Vështirësia e parashikimit të fondeve për kryerjen e shpenzimeve gjyqësore dhe proceset e mundshme të arbitrazhit ndërkombëtar.</p>	Operacional	I lartë	<p>1. Organizimi i takimeve të vazhdueshme me grupet e punës/transferim i brendshëm njohurish mbi hartimin e specifikimeve teknike.</p> <p>2. Hartim i një kalendari për dërgimin e projekteve dhe specifikimeve teknike për realizimin e prokurimeve sipas parashikimit.</p> <p>3. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me MFE dhe parashikimi i një buxheti rezervë për këto shpenzime.</p>	<p>Grup Pune N Autorizues+ D Juridike, Prokurimet + Buxheti</p> <p>(Gjashtëmuji i parë 2023)</p>

30	<p>1. Për shkak të risive ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit publik ka ende paqartësi për zbatimin e ligjit jo vetëm nga punonjësit e ngarkuar, por edhe nga njësitë e tjera.</p> <p>2. Mosdorëzimi brenda afateve ligjore në strukturat e nëpunësit zbatues i UP dhe kontratave të angazhimit.</p>	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	I lartë	<p>1. Bashkëpunim me ASPA/APP për zhvillim të trajnimeve specifike mbi legjislacionin dhe procedurat e reja të prokurimit publik për stafin e ngarkuar me realizimin e procedurave të prokurimeve.</p> <p>2. Në kuadër të miratimit të PSV të përfshihet dhe procedura me afate të qarta dhe me përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për strukturat e nëpunësit zbatues.</p>	<p>Grup Pune N. Autorizues+ D Juridike, Prokurimet + Financa+BNJ</p> <p>(Gjashtëmuajori i parë 2023)</p>
----	--	---	---------	--	--

Fusha e kontrollit, auditimit dhe mekanizmave kundër korrupsionit					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
31	Mungesë e gjurmës së auditimit të detajuar për procedurat kryesore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Operacional	I lartë	Hartimi dhe miratimi i gjurmëve të auditimit, të detajuara për procedurat kryesore, të cilat të sigurojnë që të gjitha operacionet të dokumentohen sipas kuadrit të standardeve të audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të mjedisit të kontrollit.	<p>Grup Pune</p> <p>(Gjashtëmuajori i parë 2024)</p>

V PËRMIRËSIMI I DREJTIMEVE DHE NDËRHYRJEVE TË POLITIKAVE PËR TË PROMOVUAR INTEGRITETIN DHE PARANDALUAR KORRUPSIONIN NË FUSHAT E PËRGJEGJËSISË SË MIE

5.1 POLITIKAT DHE ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS DHE TERRITORIT

5.1.1. Fusha e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrulli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
32	Mungesë e miratimit të Strategjisë Sektoriale të Transportit (SST) me pasoja në përthithjen e fondeve për investime strategjike për vendin.	Operacional/ Strategjik	I lartë	<ol style="list-style-type: none"> Hartimi i dokumentit të Strategjisë Sektoriale të Transportit (SST) duke marrë në konsideratë parashikimet e bëra në Planin Kombëtar të Transportit si dhe detyrimet që rrjedhin nga Plani i Menaxhimit të Masave të Reformës së Konektivitetit për Shqipërinë. Kryerja e një analize nga ana e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Infrastrukturës dhe Transportit për zbatimin e strategjisë së fundit në lidhje e prioritetet të përcaktuara, mbështetur në analizat e brendshme, auditimet e brendshme dhe ato të jashtme (KLSH). Analiza dhe rekomandimet t’i munikohen Grupit Tematik të Transportit dhe Komitetit Drejtues Sektorial të Ndërlidhjes me qëllim përfshirjen e tyre në draftet e strategjisë. Dokumenti të konsultohet me Asistencën Teknike të Delegacionit të BE-së (në proces) për sigurimin e kësaj TA-je. Paraqitja e draftit të strategjisë për konsultim publik sipas procedurave të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Miratimi dhe publikimi i saj në faqen zyrtare të ministrisë. 	<p>Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Infrastrukturës dhe Transportit</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023</p>

32	Vonesa në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në tërësi në mbështetje të Kodit Hekurudhor të RSH nr. 142/201 që janë në fushën e përgjegjësisë së MIE-së.	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	I lartë	Vijimi i punës për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në mbështetje Kodit Hekurudhor të RSH nr. 142/201 që janë në fushën e përgjegjësisë së MIE-së.	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Infrastrukturës dhe Transportit në bashkëpunim me Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator Gjashtëmujori i parë 2023 e në vazhdim
34	Plani i Menaxhimit të masave të Reformës së Kontektivitetit, në kuadër të Axhendës së Ndërlidhjes, nuk është i publikuar në faqen e ministrisë.	Operacional/ Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	Publikimi në faqen zyrtare të ministrisë i Planit të Menaxhimit të Masave të Reformës së Konektivitetit.	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Infrastrukturës dhe Transportit + Koordinatorin për të Drejtën për Informim Gjashtëmujori i parë 2023

35	Të dhëna statistikore jo të plota për fushën e transportit, si rrjedhojë e mungesës së bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse në këtë fushë (INSTAT, Doganat, departamentin për kufirin dhe Migracionin, Instituti i Transportit dhe organet e pushtetit vendor).	Operacional/ Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	<p>1. Lidhja e Marrëveshjeve të bashkëpunimit mes ministrisë dhe INSTAT, Doganave, Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, Institutit të Transportit dhe organet e pushtetit vendor me qëllim ofrimin e të dhënave statistikore në këtë fushë.</p> <p>2. Ngritje e kapaciteteve të burimeve njerëzore për këtë drejtori, në përpunimin e statistikave dhe klasifikimin e tyre sipas standardeve të INSTAT-it.</p>	<p>1. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Infrastrukturës dhe Transportit në bashkëpunim me Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës Gjashtëmujori i dytë 2023</p> <p>2. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023</p>
36	Vonesa në procesin e hartimit dhe miratimit të tërësisë së akteve nënligjore për transportet që janë në përgjegjësinë e MIE-së.	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	I lartë	<p>1. Kryerja e një analize të legjislacionit për transportet dhe akteve nënligjore në fuqi, që janë në përgjegjësinë e MIE-së, me qëllim identifikimin e akteve nënligjore të përcaktuara. Pjesë e analizës të jetë edhe Programi Analitik i Akteve për Ministrinë.</p> <p>2. Analiza të paraqitet pranë Drejtorisë së Programit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe titullarit të ministrisë.</p>	<p>Grup pune me punonjës nga Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit si dhe punonjës nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator</p> <p>Gjashtëmujori i parë 2024</p>

37	<p>Mungesë koordinimi ndërmjet Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit dhe Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, për procesin e hartimit të akteve nënligjore në fushën e transportit, bashkërendimit me institucionet e varësisë në këtë proces, si edhe ndjekjen e procedurave të miratimit të akteve nënligjore përkatëse.</p>	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	I lartë	<p>1. Koordinim më i mirë ndërmjet Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në fushën e Transportit dhe Territorit dhe Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në ministri, për procesin e hartimit dhe ndjekjes së procedurës për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në fushën e transportit, me qëllim shmangien e mbivendosjes së detyrave.</p> <p>2. Reflektimi i këtij rishikimi në Rregulloren e Brendshme të Ministrisë, si edhe në pershkrimet e punës për punonjësit e këtyre drejtorive.</p>	<p>1. Grup pune me punonjës nga Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe territorit në bashkërendim me Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator nën koordinimin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore</p> <p>Gjashtëmuji i parë 2023</p> <p>2. Grup pune me punonjës të ministrisë për rishikimin e Rregullores së Brendshme të Ministrisë</p> <p>Gjashtëmuji dytë 2023</p> <p>2. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore</p> <p>Gjashtëmuji i i parë 2024</p>
----	---	---	---------	--	---

38	<p>Koordinim jo i plotë ndërmjet Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës me Drejtorinë e Integritit, Marrëveshjeve dhe Asistencës për proceset: a) e identifikimit të nevojave për marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale në fushën e transportit; b) ndjekjes së procedurave ligjore për ratifikimin apo aderimin, si edhe për zbatimin e detyrimeve nga MIE, që rrjedhin nga këto marrëveshje.</p>	<p>Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual</p>	<p>Mesatar</p>	<p>1. Koordinim më i mirë për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në fushën e Transportit dhe Territorit dhe Drejtorisë së Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në ministri, në kuadër të këtyre proceseve () e identifikimit të nevojave për marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale në fushën e transportit; b) ndjekjes së procedurave ligjore për ratifikimin apo aderimin, si edhe për zbatimin e detyrimeve nga MIE, që rrjedhin nga këto marrëveshje).</p> <p>2. Reflektimi i këtij rishikimi në Rregulloren e Brendshme të Ministrisë, si edhe në pershkrimet e punës për punonjësit e këtyre drejtorive.</p>	<p>1. Grup pune me punonjës nga DPSZh IT në bashkërendim me Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në koordinimin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore</p> <p>Gjashtëmujori i parë 2023</p> <p>2. Grup pune me punonjës të ministrisë për rishikimin Rregullore të Brendshme të Ministrisë Gjashtëmujori dytë 2023</p> <p>2. Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore gjashtëmujori i dytë 2023</p>
----	---	--	----------------	--	---

39	<p>Koordinim jo i plotë mes MIE-së dhe komunitetit të donatorëve për prioritetet strategjike të MIE-së në fushën e transportit dhe infrastrukturës me axhendat e donatorëve në këto fusha me pasoja në përthithjen optimale të fondeve dhe investimeve të huaja.</p>	Operacional/ Strategjik	I lartë	<p>Realizimi i një konference të përvitshme të MIE-së me komunitetin e donatorëve, me qëllim prezantimin e prioriteve strategjike të MIE-së në fushën e transportit dhe infrastrukturës.</p>	<p>Grup pune me punonjës nga Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe territorit në bashkërendim me Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në koordinimin e kabinetit të ministrit</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023</p>
40	<p>Njohuri të kufizuara për punonjësit e kësaj drejtorie, për procesin e evidentimit të legjislacionit evropian dhe ndërkombëtar lidhur me sigurinë (safety) rrugore, hekurudhore, detare dhe ajrore në transport, me qëllim transpozimin e tij në kuadrin ligjor kombëtar, i njëjtë edhe për Traktatin e Komunitetit të Transportit (TCT).</p>	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	<p>1. Ofrim i trajnimeve në lidhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe evropian të legjislacionit evropian, lidhur me sigurinë (safety) rrugore, hekurudhore, detare dhe ajrore në transport. (ASPA)</p> <p>2. Koordinim dhe bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe Drejtorinë e Integritit, Marrëveshjeve dhe Asistencës , në kuadër të këtij procesi.</p>	<p>1. Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i dytë 2023</p> <p>2. Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe territorit në bashkërendim me Drejtorinë e Integritit,</p>

				<p>3. Parashikimi i këtij detyrimi në Rregulloren e Brendshme të Ministrisë.</p>	<p>Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës Menjëherë dhe në vazhdim</p> <p>3. Grup pune me punonjës të ministrisë për rishikimin Rregullore së Brendshme të Ministrisë Gjashtëmujori dytë 2023</p>
41	<p>Njohuri teknike të kufizuara për hartimin, përafrimin ose transpozimin e plotë të standardeve për të gjitha llojet e mjeteve të transportit, organizimin e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të lëshimit të lejeve të drejtimit dhe të administrimit të infrastrukturës nga pikëpamja e sigurisë rrugore, në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Burimet Njerëzore/ Operacional</p>	<p>Mesatar</p>	<p>1. Rritja e kapaciteteve të sektorit për hartimin, përafrimin ose transpozimin e plotë të standardeve në transport dhe infrastrukturë.</p>	<p>Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me ASPA-n dhe institucionet e përfshira në këto procese</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023</p>

42	<p>Kapacitete/burime njerëzore të paplotësuara sipas organikës/strukturës dhe pjesërisht teknike të kufizuara të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës me pasoja në realizimin me efikasitet të proceseve: a) të hartimit dhe rishikimit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian për kapitullin 14 “Politika e transportit” dhe Kapitullin 21 “Rrjetet Ndërvropiane” sipas akteve të BE-së në fushën e transportit dhe infrastrukturës; dhe b) të raportimit pranë MEPJ-së për ndekjen dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Integritimit Evropian në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA), si edhe të legjislacionit të aplikueshëm për sektorin e transport pjesë e Traktatit të Komunitetit të Transportit (TCT).</p>	<p>Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual</p>	<p>Mesatar</p>	<p>1. Shpallja e vakancave për pozicionet e punës sipas strukturës së miratuar për këtë drejtori. Dërgimi i kërkesës në DAP. 2. Ofrimi i trajnimeve për metodologjinë e re të PKIE-së, MSA -së dhe T Traktatit të Komunitetit të Transportit (ASPA dhe MEPJ).</p>	<p>1. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i dytë 2022 2. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i dytë 2023 dhe në vazhdim</p>
43	<p>Burime njerëzore të pamjaftueshme për punonjësit e sektorit të Politikave të Transportit në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive në Transport dhe Infrastrukturë me specialitete në fusha të veçanta.</p>	<p>Burimet Njerëzore/ Operacional</p>	<p>Mesatar</p>	<p>1. Vlerësim i nevojave për kapacitete teknike shtesë në Sektorin e Politikave të Transportit në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive në Transport dhe Infrastrukturë. 2. Analiza e nevojave t’i komunikohet DBNJ-së dhe titullarit të ministrisë.</p>	<p>Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit në bashkërendim me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i parë 2023</p>

44	PBA-ja jo në përputhje të plotë me prioritetet kombëtare në transport dhe infrastrukturë të propozuara nga drejtoritë e politikave në ministri.	Operacional	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtoria e Auditit të Brendshëm të përfshijë në Planin Vjetor të Auditimit PBA-në. 2. Kontrolli i rekomandimeve të vendosura nga MFE-ja në lidhje me auditimin financiar. 	<p>Drejtoria e Auditimit të Brendshëm + Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023</p>
----	---	-------------	---------	--	--

5.1.2. Fusha e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
45	1. Mungesa e një baze të dhënash në format elektronik në nivel institucioni që përmban informacion për të gjitha projektet e infrastrukturës rrugore pavarësisht formës së financimit.	Teknologjia e Informacionit/ Operacional	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> 1. Krijimi i një baze të dhënash në format elektronik me infomacion të detajuar për të gjitha projektet e infrastrukturës rrugore, pavarësisht financimit. 2. Përditësimi i kësaj baze të dhënash nga punonjësit e drejtorisë. 3. Krijimi i një liste kontrolli që do mundësojë plotësinë e informacionit të përditësuar. 	<p>Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023</p>
46	Mungesa e një analize vjetore për zbatimin e projekteve të infrastrukturës rrugore përfshi edhe ato me financim të huaj, për problematikat dhe çështje të tjera.	Operacional	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryerja e një analize vjetore, nga Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban, për zbatimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, problematikat dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin. 2. Analiza i paraqitet titullarit të ministrisë dhe Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Infrastrukturës dhe territorit. 3. Përcaktimi i këtij detyrimi në Rregulloren e Brendshme të ministrisë. 	<p>Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023</p>
47	Mungesa e një PSV-je të brendshme për përgatitjen, përpunimin e dokumentacionit për financimin e projekteve me financim të huaj, lidhja e marrëveshjeve, si edhe përgatitja e akteve për ndryshime të mundshme në marrëveshje.	Operacional	I lartë	Hartimi i një PSV-je të brendshme për përgatitjen dhe përpunimin e dokumentacionit për financimin e projekteve me financim të huaj.	<p>Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban</p> <p>Gjashtëmujori i parë 2024</p>

48	Mundësi e ngjarjeve të jashtëzakonshme me përmbytjet dhe pasojat e tyre në diga, nisur nga anomalitë e klimës.	Operacional	I lartë	<p>1. Bashkëpunim me institucionet që mbajnë përgjegjësinë për sigurinë e digave /dambave, për të gjitha aktet ligjore e nënligjore të dala në kohë të ndryshme për një bashkërendim më të mirë midis tyre që të rritet efikasiteti i zbatueshmërisë nëpërmjet monitorimit e kontrolleve të vazhdueshme të digave .</p> <p>2. Të bëhet një studim i detajuar për vlerësimin paraprak të rrezikut në diga dhe masat që duhen marrë për parandalimin e tyre.</p>	<p>1. Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban</p> <p>Gjashtëmuji i parë 2023</p> <p>2. Grup teknik pune me punonjës të ministrisë dhe institucioneve të varësisë dhe ekspertë të fushës</p> <p>Gjashtëmuji i parë 2024</p>
49	Proces në vazhdueshmëri I dërgimit të pasaportave të digave nga shfrytëzuesit e tyre dhe përditësimi i informacioneve të mbërritur në regjistrin kombëtar të digave të mëdha.	Teknologjia e Informacionit/ Operacional	Mesatar	<p>1. Krijimi i një baze të dhënash (arkivë teknike digjitale) më të gjithë informacionin e plotë për pasaportat e digave dhe dambave në vend, te hedhura në faqen e KKDM-së albcold.gov.al.</p> <p>2. Përditësimi i saj me informacionin për riparimet apo përmirësimet që mund të jenë realizuar në vazhdimësi.</p> <p>3. Kontrolli i dokumentacionit dhe plotësimi i dosjeve teknike/ pasaportave të digave dhe dambave për digat që janë në shfrytëzim.</p>	<p>Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban +STDM</p> <p>Gjashtëmuji i parë 2024</p>

50	Vështirësi në procesin e përgatitjes së materialeve të mbledhjeve për shqyrtim nga KTPD-ja dhe KKDM-ja, shpërndarja, si dhe riformulimi i tyre mbi bazën e vërejtjeve të bëra në mbledhje.	Operacional	I lartë	<p>1. Sekretariati i digave përgatit materialet për shqyrtim në mbledhjen e KKDM-së, sistemimi, shtypja, shumëfishimi, shpërndarja dhe riformulimi i tyre mbi bazën e vendimeve të dala nga mbledhjet mujore të KKDM-së.</p> <p>2. Informimi i të gjithë institucioneve që, administrojnë dhe shfrytëzojnë diga/damba.</p>	<p>Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban</p> <p>Gjashtëmujori i parë 2023 dhe në vazhdimësi</p>
51	Siguri e pamjaftueshme e digave/dambave për shkak të ngritjes së qendrave të reja të banimit ose të objekteve të tjera ekonomike poshtë tyre	Operacional	I lartë	<p>1. Rritja e sigurisë nëpërmjet kontrolleve dhe kontakteve të vazhdueshme me Ministrinë e Bujqësisë, Prefektura/Bashkitë si shfrytëzues të digave. 2. Zbatimi i ligjshmërisë nga ana e institucioneve dhe organeve që administrojnë diga si dhe kontakte dhe korrespondenca të vazhdueshme me to.</p>	<p>Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban +SP</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023 dhe në vazhdimësi</p>
52	Mungesë buxheti për procesin e organizimit të seminareve nëpër prefektura, dhe botimet e buletinit teknik të digave /dambave.			<p>1. Përfshirja në buxhetin e ministrisë së nevojave për kryerjen e seminareve dhe botimin e buletinëve teknike të digave/dambave. 2. Organizimin e veprimtarive teknike dhe praktike në prefektura me specialistë që merren direkt me administrimin dhe shfrytëzimin e tyre, kushteve teknike, për vlerat dhe rreziqet që mbartin, gjatë kohës së shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.</p>	<p>1. Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban + Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023</p>

				2. Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban Gjashtëmujori i parë 2023	
53	Mosfunksionimi i Inspektoratit Teknik të Digave sipas prashikimeve në ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” i përditësuar.	Operacional	Mesatar	<p>1. Ushtrimin e kontrollit gjatë ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së digave/dambave si dhe përcaktimin e të metave të mundshme në diga e damba.</p> <p>2. Informimi i KKD-së për kontrollet e ushtruara si dhe përgatitja e një materiali në lidhje me gjendjen e digave/dambave.</p>	<p>Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban +SP</p> <p>Gjashtëmujori i parë 2023</p>

5.1.3. Fusha e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Ujësjellës dhe Kanalizimeve

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
54	<p>1. Strategji Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2021-2030 nuk është e miratuar.</p> <p>2. Papërputhshmëri të draftit aktual me ndryshimet që sjellin reformat e ndërmarra në sektorin e ujësjellës dhe kanalizimeve.</p>	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	<p>1. Përditësimi i draftit aktual të Strategjisë së Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2021-2030, me ndryshimet e rrjedhura nga reformat e ndërmarra në sektorin e kanalizimeve dhe ujësjellësit.</p> <p>2. Ndjekja e procedurave ligjore për miratimin e dokumentit të Strategjisë. 3. Përditësimi i legjislacionit në fuqi për ujësjellës dhe kanalizimet me reformat e ndërmarra në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve.</p>	<p>Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Ujësjellës Kanalizimeve, në bashkërendim me Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator</p> <p>Gjashtëmujori i dytë 2023</p>
55	Njohuri të kufizuara për procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë evropian në fushën e ujësjellës kanalizimeve.	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	Trajnime për punonjësit e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Ujësjellës Kanalizimeve dhe për procesin e përafrimit të legjislacionit evropian.	<p>Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore</p> <p>Gjashtëmujori i parë 2023</p>

5.1.4. Fusha e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
